



**VENDIM**

*Nr. 128, Datë 29.10.2015*

**MBI**

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “STRELCA ENERGY” SH.P.K NË  
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
HEC-ET “STRELCA 1” ME FUQI TË INSTALUAR 1504 KW,  
“STRELCA 2” ME FUQI TË INSTALUAR 325 KW DHE “STRELCA 3”  
ME FUQI TË INSTALUAR 3520 KW (ME FUQI TOTALE 5349 KW)**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2 gërma “a”, 39 pika 3 dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 13 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.10.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “STRELCA ENERGY” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga Hec-et “Strelca1”, “Strelca 2” dhe “Strelca 3”;

**Konstatohet se :**

Aplikimi i shoqërisë “STRELCA ENERGY” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 ) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko – ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 43.1.5), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të licensojë shoqërinë “STRELCA ENERGY” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et “Strelca 1” me fuqi të instaluar 1504 KW, “Strelca 2” me fuqi të instaluar 325 KW dhe “Strelca 3” me fuqi të instaluar 3520 KW (me fuqi totale 5349 KW).
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari**

Petrit Ahmeti